



A mban takime ekipi dhe si mund ta kontaktojmë?!

Ekipi takohet së paku një herë në tre (3) muaj, ndërsa mund të takohet edhe më shpesh me kërkesë të kryesuesit, apo me kërkesën e së paku 1/3 e anëtarëve të tij.

Kryesuesi apo ndonjëri prej anëtarëve mund të kërkojë caktimin e mbledhjes së jashtëzakonshme kur interesi publik dhe ai i fëmijëve e kërkon me urgjencë mbajtjen e një takimi të tillë, ndërsa Vendimet e Ekipit, merren me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm.

Përgjashtimisht nga anëtarët e rregullt, vëzhguesit dhe këshilltarët e jashtëm në takim mund të marrin pjesë edhe grupe të tjera të interesit, mirëpo pa të drejtë vote.

Takimet e Ekipit janë të hapura për publikun, mirëpo Ekipi mund të vendos që disa çështje të ndjeshme t'i shqyrtojë në takim të mbyllur.

Ekipi mund të kontaktohet përmes sekretariatit të Ekipit, që është zyrtari për të drejtat e fëmijës apo zyra e për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore në komunë, apo/edhe përmes zyrës së informimit në komunë.



Çka mund të bëj unë si qytetar?

Si qytetar, fëmijë dhe çdo person tjetër që vëren ose ka informacion për një situatë ose akt që mund t'i nënshtrohet, ose që ndaj fëmijës është ushtruar çfarëdo formë e dhunës fizike ose mendore, keqtrajtimi, braktisja, abuzimi, neglizhimi dhe shfrytëzimi është i obliguar që të raportojë rastin, me shkrim ose me verbalisht në polici, apo në Qendrën përkatëse për punës sociale. Një ndër mënyrat e vetme se si mund t'i japim çdo fëmije një shans të drejtë në jetë, në një mjedis të sigurt, të pastër, të mbrojtur nga dhuna dhe shfrytëzimi është nëse veprojmë bashkërisht.

Andaj, inkurajoheni të bashkëpunoni me Ekipin për të Drejtat e Fëmijës për të rritur ndërgjegjësimin, llogaridhënien, transparencën për të drejtat e fëmijëve, si dhe për të ndryshuar qëndrimet, praktikat dhe për të promovuar shërbime cilësore e miqësore për çdo fëmijë në komunën tuaj.



EKIPI PËR TË DREJTAT E FËMIJËS NË KOMUNË



Kush jemi ne?!

Jemi një trup komunal, i themeluar sipas Ligjit nr.06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, i cili punon dhe angazhohet për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, përmirësimin e mirëqenies sociale, mbrojtjen nga dhuna dhe dukuritë tjera që cenojnë të drejtat dhe interesin me të mirë të të gjithë fëmijëve në komunën tonë.



Ekipi për të Drejtat e Fëmijës përbëhet nga dymbëdhjetë anëtarë:

1. Kryetari i Komunës, kryesues i Ekipit;
2. Drejtorja për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, zëvendës kryesues/e e Ekipit;
3. Drejtorja përkatëse për arsim, anëtar/e;
4. Drejtorja përkatëse për shëndetësi, anëtar/e;
5. Drejtorja përkatëse për rini, kulturë dhe sport, anëtar/e;
6. Drejtorja përkatëse për buxhet dhe financa, anëtar/e;
7. Anëtar i deleguar nga Komiteti për politikë dhe financa i Kuvendit të Komunës, anëtar/e;
8. Anëtar i deleguar nga Komiteti për komunitete i Kuvendit të Komunës, anëtar/e;
9. Zyrtari për mbrojtje të fëmijës/Njësia për drejta të njeriut, anëtar/e;
10. Policia, anëtar/e;
11. Qendra për Punë Sociale, anëtar/e;
12. Përfaqësues nga shoqëria civile, anëtar/e.

Në cilësinë e anëtarëve vëzhgues dhe këshilltarëve të jashtëm janë:

1. Përfaqësuesi i fëmijëve apo grupit të fëmijëve;
2. Kryetari i Këshillit të Prindërve;
3. Përfaqësuesi nga zyra rajonale e Institucionit të Avokatit të Popullit;
4. Përfaqësuesi i organizatave vendore dhe ndërkombëtare.

Plani i punës së Ekipit

Ekipi harton planin trevjeçar të punës për mbrojtjen e fëmijës për të siguruar që të drejtat dhe mirëqenia e fëmijëve të jenë të garantuara dhe të respektohen në pajtim me parimet themelore të të drejtave të fëmijëve sipas Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës dhe Ligjit nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës. Ekipi e harton planin përmes një procesi vlerësues të politikave, legjisllacionit, dhe strategjisë nacionale për të drejtat e fëmijës. Kryesuesi/ja angazhohet dhe garanton përfaqësimin e barabartë gjinor dhe të grupeve të fëmijëve gjatë hartimit të planit i punës. Plani, më pas, duhet të miratohet nga Kuvendi Komunal.



Çka përmban plani i punës?!

Plani përfshin të gjitha nevojat dhe të drejtat që fëmijët kanë në fusha të ndryshme si :

- përmirësimin e mirëqenies sociale;
- përmirësimin e kushteve në arsim dhe rritjen e cilësisë;
- shërbime shëndetësore më cilësore;
- qasje me të lehtë në shërbime publike,
- mundësi për zhvillim të talentit në kulturë dhe sport;
- krijimin e mundësive dhe hapësirave të reja për kohë të lirë dhe rekreacion.

Përmes këtij plani shërbimet ndaj fëmijëve do të jenë më cilësore e gjithëpërfshirëse, duke ofruar mundësi të reja që komuna të jetë një mjedis miqësor për ta, si dhe duke u angazhuar që të mbrohet dhe respektohet interesi më i mirë i tyre.

Ky material është financuar nga Qeveria Suedeze me mbështetje të Save the Children. Përgjegjësia për përmbajtjen qëndron tek Syri i Vizionit. Qeveria Suedeze apo Save the Children jo domosdoshmërisht i ndan pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura.

